



Permbledhje joteknike e aktiviteve

“Blegtoria, ID 7.8 a. Rritje intensive e shpendëve në një instalim.”



Subjekti: “Fermer-Boris Allmuca”

Hartoi: “EKO- STUDIO- PROJEKT” sh.p.k

Administrator: Shkelzen MADANI



Tirane, 2023



PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
4. **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



HYRJJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre tepashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qeeshtebere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim teakteveligjoredhe nenligjoreMjedisore:

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit neMjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes sekuqeteflores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelinkufi tezhurmave nemjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjese marrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit nemjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per lejemjedisi tetipave A,Bdhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autori te te kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*
- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*




1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

Operatori "Fermer-Boris Allmuca" me numer identifikimi (NIPT/SSN) L92102451L dhe do te ushtroje aktivitetin "Rritje intensive e shpendëve në një instalim". Aktiviteti do te zhvillohet ne adresen Mumajes, Baldushk, Tirane.

Operatori eshte i pajisur me Deklarate Mjedisore per projektin "Instalim per mbareshtimin intensiv te pulave", ku sipas planimetrive ne faqen e fundit te saje, deklarohet siperfaqja e kpanoneve prej $3542 m^2$. Gjithashtu subjekti eshte i pajisur me VNM Paraprake per projektin "3 magazina bujqësore 1 kat dhe objekt për zyra 1 kat", i cili perfshin siperfaqen totale te zhvillimit te projektit prej $12080 m^2$. Si Deklarata Mjedisore dhe VNM Paraprake jane hartuar per te njejten vendodhje Mumajes, Baldushk, Tirane.

Nga sa me larte u tha, aktiviteti do te zhvillohet ne nje zone me siperfaqe totale $12080 m^2$ dhe siperfaqe e gjurmes se objektit $3542 m^2$ dhe ka nje kapacitet prej mbi **40100 krere vende shpendesh**.



Koordinatat e prones ne sistemin Ghauss Kruger

	X	Y
1.	4401336.07	4567999.30
2.	4401341.41	4567964.09
3.	4401369.18	4567907.76
4.	4401309.29	4567876.17
5.	4401310.74	4567868.59



6.	4401301.32	4567865.20
7.	4401278.95	4567844.47
8.	4401252.51	4567887.78
9.	4401252.22	4567899.13
10.	4401259.46	4567920.05
11.	4401252.29	4567967.10
12.	4401351.12	4567953.98
13.	4401362.06	4567931.45
14.	4401246.03	4567972.83

- **Pershkrimi i aktivitetit**

Njohja me ambientin me te cilen rritet zogju

Ambienti me te cilin do te rriten zogjte do te sherbeje nje kapanon i standartizuar i cili do te ndertohet posacerisht per kete zhvillim. Ai do te jete ne kushte shume te mira, gjithashtu do te kete te gjitha kapacitetin e nevojshem dhe hapsiren e mundshme per zhvillimin e ketij aktiviteti. Kapaciteti i rritjes se zogjve eshte mbi 20.000 krere zogj. Per te plotesuar kushtet per rritjen e zogjve ne lokale eshte vendosur nje impiant uji i perbere nga tre linja uji, nje impiant per ushqimin e zogjve i perber nga 2 linja ushqimi te kompletuara me pjata dhe me panelin e komanduar automatik, tre linja me ndricues, ventilatoret per qarkullimin e ajrit , aparati i matjes se temperatures dhe paneli elektrik i kontrollit me anen e te cilit behet komandimi ne menyren e duhur e te gjitha proceseve.

Pergatitja e lokalit per priten e zogjve

Etapa e pare e pergatitjes se lokalit eshte pastrimi i tij nga mbetjet (plehu) e tufes se pare, me pas behet larja e lokalit, proces te cilit i kushtohet nje rendesi e vecante. Lokali pasi eshte pastruar dhe lare lihet te thahet per disa dite, me pas behet izolimi mbyllja e dritareve, dyerve, aspiratoreve ne menyre qe dizinfektimi te behet sa me mire dhe te japi rezultate sa me pozitive. Pasi kane mbaruar keto procese behet dezinfektimi i ambientit ne menyre te imtesishme dhe ne sasine e duhur te dizinfektantit dhe lokali lihet i mbyllur per 24 ore.

Pritja e zogut

Duke u mbeshtetur dhe ne kushtet klimaterike hapja e lokalit behet 1 ose 2 dite para mberitjes se zogut. Gjate kesaj kohe behet ngrohja e lokalit me ane te ngroheseve pergatitja e rrethakeve dhe vendosja e piresve te ujit dhe kupave te ushqimit brenda ne rrethak. Gjithashtu behet larja e linjave te ujit dhe me pas ato lihen te mbushura me uje me sode gje e cila ndihmone ne pastrimin e linjave te ujit dhe ne heqjen e mbeturinave.

Pershtatja e aparaturave sipas moshes se zogjve

Ne ditet e para zogu ushqehet si e permendem me siper me pas rreth dites se 3 zogu hiqet nga rrethakja dhe uji thithet ne menyre automatike me ane te linjave te ujit duke lene dhe disa pires shtese ndersa zogu te mesohet te pije uje ne linja. Menyra e ushqimit vazhdon e njejte si ditet e pare deri ne moshen 10-15 ditesh, me pas vendosen linjat automatike te ushqimit. Pra zogu ushqehet sipas dshires. E rendesishme ne rritjen e tyre eshte temperatura dhe ventilimi.



Pergatitja e ushqimit dhe perberesit kryesor te tij

Nje pike e rendesishme ne realizimin me sukses te kesaj veprimtarie eshte edhe ushqimi. Perberesit kryesor jane misri dhe soja. Rreth 80 % te ushqimit e perben misri, soja perben 28 % dhe pjesa tjeter perbehet nga vaji, karbonat dhe nukleusi qe i nevojitet zogut per te marr sasine e duhur te proteinave, energjise dhe gjithcka qe i nevojitet per nje rritje pa probleme. E rendesishme nuk eshte vetem perberja e ushqimit por edhe madhesia e kokrres se ushqimit. Ne periudhen e pare deri ne 21 dite kokrra e ushqimit duhet te jete shume e vogel, me pas ushqimi behet me i ashper ne menyre qe zogu mund ta konsumoj pa probleme.

Rregullat per mbrojtjen nga faktoret e jashtem

Rendesi e vecante i kushtohet mbrotjes nga faktoret e jashtem per kete perdoret ajo qe quhet karantine, domethen nuk lejohet kalimi i punetoreve dhe materialeve te ndryshem nuk lejohet hyrja e makinave te huaja ne territorin e kompleksit. Makinat perpara se te futen ne kete ambient u behet nje dezinfektim me sperkatje.

Programi i mbareshtimit te zogjve

Zogjte mbareshtrohen sipas nje programi zooteknik-veterinar te perpiluar nga specialiste perkates. Ky program mbeshetet ne keto pika:

- Normat eventilimit te lokalit
- Normat e ushqimit sipas fazes se rritjes se zogjve
- Pershtatja e temperatures sipas moshes se zogjve
- Programi i vaksinimeve. Me ane te vaksinimit parandalohen semundjet kryesore qe qarkullojne.
- Perdorimi i medikamenteve te ndryshme, me ane te te cileve luftohen infeksionet e mundshme.

Lendet e para

Lendet e para te cilat hyjne ne procesin teknologjik eshte ushqimi per shpendet (pulat), uje dhe energjia elektrike.

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Pozita Gjeografike

Tirana ndodhet 110 metra mbi nivelin e detit. Lartësia mesatare e fushës së Tiranës është 521 m, kurse dy malet më të larta rrez të cilëve shtrihet janë Mali i Dajtit me 1612 m dhe Mali me Gropa me 1828 m. Qyteti gjendet rreth 34 kilometra larg detit Adriatik në perëndim. Nga jugu dhe perëndimi rrethohet nga kodra relativisht të ulta, kurse nga ana veriperëndimore Tirana shtrihet mbi një zonë të rrafshët. Në periferinë veriore kalon lumi i Tiranës. Disa kilometra më tutje nga ana jugore rrjedh lumi i Erzenit. Sipërfaqja e qytetit të Tiranës është rreth 31 km², ndërsa sipërfaqja e gjithë rrethit është 1288 km² dhe përfshin katër qendra: Tiranën, Vorën, Krrabën dhe Kamzën si dhe 150 fshatra. Qendrën e Tiranës e përshkon përroi i Lanës i cili në grykëderdhje bashkohet me lumin Ishëm.

Kushtet klimatike

Ajri eshte me lageshti mesatare 60-80%. Persa i perket cilesise se ajrit ai konsiderohet jo



shume i ndotur pasi zona nuk eshte zone industriale qe te prodhoje gaze ndotese per ajrin. Ndotja e ajrit vjen vetem nga pluhurat qe krijohen nga levizja e automjeteve apo dhe aktivitetete te tjera nerezore. Temperatura mesatare vjetore është 16°C. Sasia mesatare e reshjeve është 1297mm. Lartësia mesatare mbi nivelin e detit 57m.

Tirana ka 331 ditë me diell në vit dhe këto kushtëzohen nga pozicioni gjeografik, vranësiat dhe pozicioni i vendit të matjes. Intensiteti i rrezatimit të drejtpërdrejtë i diellit është më i lartë në muajin Maj, ndërsa më i ulët në Dhjetor. Kurse vlera më e lartë në mesditë është gjatë muajit Korrik. Reshjet në Tirane kryesisht përfaqësohen nga rëniet e shiut, që kapin shifrën 128 –139 ditë reshje në vit. Lagështia mesatare ditore e ajrit është rreth 72%. Tirana ka një thatësi të zgjatur që varion nga 9 deri 11 javë në vite.

Tirana - Temperatura dhe reshjet mesatare mujore

	Jana	Shkur	Mar	Pril	Ma	Qersho	Korrik	Gush	Shtato	Teto	Nënto	Dhjetor	
	r	t	s	l	j	r	k	t	r	r	r	r	
Temp · Maks. (°C)	12	12	15	18	23	28	31	31	27	23	17	14	Ø 20,9
Temp · Mini. (°C)	-8	-8	-4	-1	3	6	11	10	5	1	-3	-7	Ø 0,4
Reshje (mm)	135	152	128	117	122	86	32	32	60	105	211	173	Σ 1.353

Era

Eshte një element shumë i ndryshueshem nga një zonë në një tjetër për shkak të ndikimit të madh që relievi ka mbi të. Megjithatë, duke marrë parasysh kushtet gjeografike të zonës dhe relievit përreth, erërat nuk karakterizohen nga një shpejtesi e madhe . Erërat mbizotëruese janë kryesisht lindore dhe juglindore dhe ndonjëherë ka erëra te nxehta .

Lagështia

Zona ne fjale eshte e karakterizuar nga një nivel relativisht i lartë i lagështisë, me një vlerë vjetore mesatare prej 73%. Vlera më e ulët është vërejtur në korrik me 67% dhe më të lartë në dhjetor me 76%.



🌿 Toka/Flora/Fauna

Tokat ne kete zone jane ngjyre hiri, kafe qe shtrihen ne formen e brezave vertikale deri ne lartesine me te medha te zones. Ky ekosistem perfaqesohet nga tokat e mbjella me kultura te ndryshme bujqesore dhe nga druret frutore qe jane mjaft te perhapur ne kete rajon. Toka e zones nuk eshte e kultivueshme dhe nuk perfaqeson siperfaqe te shfrytezueshme si kullote.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet qe zhvillohet shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis, qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per tu zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikesht ndikimet e cdo operacioni te kryer.

Shkarkime ne uje

Sistemi i furnizimit te kompleksit me uje per nevojat jetesore eshte i mbyllur, pahumbje I kontrolluar ne menyre automatike dhe praktikisht pa asnje mundesi shkarkimi ne ujerat e ambientit. Pjesa jeter e ujit e rrjetit ujembledhes te instaluar ne kompleks depozitohet ne vasken e ndertuar per kete qellim, ku i nenshtrohet trajtimit me klor per nje periudhe 5 ditore. Pra gjate punes normale te aktiviteti nuk kemi shkarkime ne mjedisin ujqor prites qe e ndot ate. Nuk do te kemi shkarkime as ne mjedise ujqore siperfaqesore as ne mjedise ujqore nentokesore.

Emetimet ne ajer

Operatori do te perdore energjine elektrike per mbajtjen konstante ambientit te rritjes se zogjve. Per kete arsye nuk do te kemi shkarkime te cilat pasohen me ndikime negative. Ne mjedis. Ndikime te mudshme mund te kemi vetem gjate transportimit te gjese se gjalle nga mjetet e transportit si dhe nje ndikim tjetere i mundshem do te ishte edhe perhapja e aromave.

Zhurmat dhe vibrimet

Gjate operimit nuk do te kemi nivele te larta zhurme, e thene kjo ne reference te zhvillimit te aktivitetit. Niveli i zhurmave do te jete i pranishem vetem ne momentin e transportimit te zogjve, por do te jete ne parametra normale.

Mbetjet e prodhuara

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk gjenerohen mbetje te ngultra te cilat te oerbejne rrezik per ndotjen e tokes, jashteqitjet e zogjve pasi trajtohen ne kompleks shkojne per perdorim te plerherimit te tokes nga ana e fermerave.

Mbetjet te cilat do te gjenerohen nga aktiviteti i perditeshem i punonjesve si kartona apo plastika do te grumbullohen si fillim ne vendin e percaktuar nga drejtuesit dhe me pas do te



dergohen ne vendin e percaktuar nga Njesia e qeverisjes vendore. Theksojme se nuk do te kemi kemi gjenerime te mbetjeve te rrezikshme.

Ndikime ne biodiversitet

Gjate fazes se funksionimit te ketij aktiviteti nuk do te kemi ndikime ne biodiversitet. Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i shoqerise.

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Masat per shkarkimet ne uje

Ujerat te cilat dalin nga pastrimi i lokaleve perpara se te shkarkohen ne kanalin kryesor dekantojne ne gropen dekantuese, keto ujera nuk permbajne elemente kimike te rrezikshem per mjedisin ujqor prites. Ujerat e shiut drejtohen permes kanalizimeve drejt kolektorit kryesor sebashku me ujerat e perdorimit nga aktiviteti njerezor.

Operatori do te ndertoje sistemin e drenazhimit te ujrave te shiut ne perimetrin e rrethues te aktivitetit.

Masat per emetimet ne ajer

Operatori do te perdore energjine elektrike per mbajtjen konstante ambjentit te rritjes se zogjve. Per kete arsye nuk do te kemi shkarkime te cilat pasohen me ndikime negative. Ne mjedis. Ndikime te mudshme mund te kemi vetem gjate transportimit te gjese se gjalle nga mjetet e transportit por edhe per kete do meren masa duke ushtruar kontrrolle periodike te kushteve teknike te mjeteve te transportit.

Nje ndikim tjeter i mundshem do te ishte edhe perhapja e aromave, por operatori duke instaluar nje teknologji bashkohore dhe moderne, me ane te sistemit te aspirimit dhe mbajtjes paster te ambjentit ne te cilin mbahen zogjte do te beje te mundur minimizim maksimal te ketij fenomeni. Edhe pse zona ku do te zhvillohet aktiviteti eshte larg qendrave te banuara operatori do te mane masat e nevojshme.

Mbetjet e prodhuara

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk gjenerohen mbetje te ngulata te cilat te oerbejne rrezik per ndotjen e tokes, jashteqitjet e zogjve pasi trajtohen ne kompleks shkojne per perdorim te plerherimit te tokes nga ana e fermereve.

Mbetjet te cilat do te gjenerohen nga aktiviteti i perditshem i punonjesve si kartona apo plastika do te grumbullohen si fillim ne vendin e percaktuar nga drejtuesit dhe me pas do te dergohen ne vendin e percaktuar nga Njesia e qeverisjes vendore. Theksojme se nuk do te kemi kemi gjenerime te mbetjeve te rrezikshme.

Masat per mbrojtjen nga insektet dhe brejtesit



Gjithashtu do të merren masa për mbrojtjen nga insektet dhe brejtësit brenda kabanonit dhe në mjediset rreth tij. Për këto personeli do të mbaje pastër dhe do të zhvillojë kontroll të shpeshtë të mjedisëve ku ruhen drithërat si dhe lenDET e tjera ushqimore për shpendet. Gjithashtu për të shmangur këto fenomene ekskrecionet largohen sistematikisht nga lokali.

Masat për mbrojtjen kundër zjarrit

Masat për mbrojtjen kundër zjarrit janë shumë të rëndësishme. Ato janë parashikuar në projekt dhe janë si më poshtë:

- Largimin e materialeve të ndezshme nga ambientet e godinës dhe vendosjen e tyre në vende të sigurta për parandalimin e transmetimit të zjarrit
- Mbajtje e lire e rrugëve të largimit
- Mirembajtje dhe kontroll i vazhdueshëm i instalimeve elektrike në përputhje me rregullat përkatëse për instalime të tilla.
- Pozicionimi i shenjave në vende të dukshme dhe vendosja e instruksioneve për veprimet që duhet të kryejë personeli në rast zjarri.
- Pozicionimi i shenjave që paraqesin pozicionet e shuaresve të zjarrit, rrugët e largimit dhe daljet e emergjencës.
- Duke marrë në konsideratë karakteristikat e ndërtesës si dhe destinacionin e saj janë përdorur substanca shuarese si më poshtë:
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidratante të jashtëm
 - Sistem i mbrojtjes me uje me hidrante të brendshëm
 - Shuares portable në të gjitha pozicionet të cilat parashikohen në projekt.

Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet në punë

Detyrimet e punëdhënësit

Për të shmangur aksidentet në punë, punëdhënësi vetë i ka bërë të ditur punëmarrësve:

- Proçesin teknologjik në tërësi dhe specifikat e punës në vendin e punës ku punon secili.
- Pajisjet dhe makineritë që janë në përdorim.
- Mundësitë për aksidente, shkaqet dhe masat për mënjanimin e tyre.
- Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë në Republikën e Shqipërisë, aktet ligjore dhe udhëzimet në zbatim të tyre, lëshuar nga institucionet përgjegjëse.
- Veçoritë e punës në instalimin ku do të punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë për të shmangur aksidentet dhe ruajturi shëndetin e punonjësve që do të punojnë.

Detyrimet e punëmarrësit:

- Të njoh mirë proçesin e punës dhe makineritë apo pajisjet që ka në përdorim.
- Të njoh rregullat e sigurimit teknik që lidhen me frontin e punës ku punon.
- Të mbrojtë veten dhe shokët gjatë punës.
- Kur konstatojnë rrezik apo mundësi të ndodhjes së avarive që çojnë në rrezikim të jetës, të dijë çfarë masash duhen marrë për shmangien e rrezikut.
- Të dijë të përdorë mjetet mbrojtëse në punë.
- Të ketë njohuri të mjaftueshme për ndihmën e shpejtë.
- Të mos përdorë pije alkoolike para fillimit të punës dhe gjatë kohës së punës.